

# RREGULLORE

## E

# KUÇOVA INTERNATIONAL INDEPENDENT FILM FESTIVAL (KIIFFF) EDICIONI 1-rë

12-17 Tetor 2026, Kuçovë, Shqipëri

## NENI 1

### QËLLIMI I FESTIVALIT

1.1. Kuçova International Independent Film Festival (në vijim “KIIFFF”) ka për qëllim të promovojë filmin e pavarur kombëtar dhe ndërkombëtar, të nxisë dialogun kulturor dhe të kontribuojë në zhvillimin kulturor e turistik të qytetit të Kuçovës.

1.2. Festivali synon të ofrojë një platformë për autorë të rinj dhe të afirmuar, duke vënë në qendër vlerat artistike, origjinalitetin dhe diversitetin e perspektivave që zhvillohen nëpërmjet filmit independent.

## NENI 2

### DATA DHE VENDI I ORGANIZIMIT

2.1. KIFF do të organizohet në Kuçovë, Shqipëri, në datat 12-17 Tetor 2026.

2.2. Filmat artistikë, dokumentarë dhe të animuar independentë, do të shfaqen në kinema “Kadri Roshi”. Kuçovë.

2.3. Filmat që do të marrin pjesë në konkurim në këtë Festival duhet të jenë prodhuar në periudhën 2019-2024.

## NENI 3

### KATEGORITË E KONKURRIMIT DHE ÇMIMET

3.1. Kategoritë kryesore të konkurrimit në KIIFFF janë:

- Best Feature Film;
- Best Short Film;
- Best Documentary;
- Best Animation Film;
- Jury Special Mention.

3.2. Producenti rezervon të drejtën të shtojë, bashkojë ose modifikojë kategori, si dhe të krijojë programe jo-konkurruese (screenings speciale, retrospektiva, programe tematike).

#### **ENI 4**

#### **STRUKTURA E FESTIVALIT**

4.1. KIFF - Edicioni 1, organizohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS), Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK) dhe Bashkisë Kuçovë (BK).

4.2 Festivali do të organizohet nën kujdesin e veçantë të z. Kreshnik Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, President i KIFF.

#### **ENI 5**

#### **DETYRAT E PRESIDENTIT**

5.1. Konsultohet me Drejtorin e Festivalit për problemet që kanë të bëjnë me organizimin e Festivalit, por në mënyrë të veçantë me ato probleme që kanë të bëjnë me realizimin konkret të përmbajtjes dhe të qëllimit të organizimit të Festivalit

5.2. Propozon përbërjen e jurisë së filmave konkurrues, në bashkëpunim me Drejtorin e Festivalit.

5.3. Miraton Rregulloren e KIFF, së bashku me Drejtorin e Festivalit.

5.4. Dorëzon personalisht kupat për fituesit e Festivalit, apo cakton për këtë qëllim personalitete të tjera të artit dhe të kulturës.

5.5. Nënshkruan, së bashku me Drejtorin e Festivalit ftesat për pjesëmarrje në KIIFFF, drejtuar trupit diplomatik, personaliteteve të artit, jetës publike, etj.

5.6. Mban fjalën e hapjes e të mbylljes së Festivalit, ose fton për këtë të fundit personalitete të kulturës shqiptare.

## **NENI 6**

### **DETYRAT E DREJTORIT TË FESTIVALIT**

6.1. Përgjigjet për mbarëvajtjen dhe realizimin me sukses të Festivalit. Drejton komponentët artistikë të Festivalit.

6.2. Hyn në negociata, apo i delegon Produksionit kompetencën për të kërkuar mbështetje financiare në organizma publikë dhe privatë, donatorë dhe/ose sponsora vendas apo të huaj. Fondet e siguruara duhet të përdoren në funksion të realizimit me nivel sa më të lartë të KIIFFF.

6.3. Mbikëqyr Produksionin në fazën përgatitore, si dhe gjatë ditëve të zhvillimit të Festivalit.

6.4. Miraton çdo detaj të anës vizive dhe organizative, përfshirë gjithë aksesoret e nevojshëm për mbarëvajtjen e Festivalit.

6.5. Në bashkëpunim me Produksionin, në bazë të mundësive financiare përcakton numrin e të ftuarve V.I.P., të cilët do të marrin pjesë në ditët e zhvillimit të Festivalit.

6.6. Në bashkëpunim me Produksionin miraton strukturën dhe Komisionet e nevojshme për garantimin e mbarëvajtjes së Festivalit, të cilët do të jenë si më poshtë:

#### **i. Njësia e medias dhe publicitetit, e cila ka për detyrë:**

- Organizon konferencat e shtypit të hapjes dhe mbylljes së Festivalit, në të cilat Presidenti dhe Drejtori i Festivalit do të njohin gazetarët me të gjitha të dhënat e nevojshme për Festivalin.

- Përgatit buletin ditor të aktiviteteve të Festivalit dhe informon mediat.
- Me pjesëmarrjen e kineastëve, organizon tryezën e debatit – masteclass.
- Në bashkëpunim me partnerin mediatik të Festivalit, përgatit materialet e nevojshme për realizimin e emisioneve speciale për të pasqyruar sa më gjerësisht Festivalin dhe aktivitetet e tij.
- Në varësi të mundësive financiare, formon një redaksi e cila të botojë një gazetë të posaçme për pasqyrimin e gjithë aktivitetin e Festivalit.

#### **ii. Njësia e mikpritjes, e cila ka për detyrë:**

- Harton listën e të ftuarve dhe shpërndarjen e ftesave, sigurimin e kopjeve fizike të filmave, prezantimin e autorëve të tyre në publik, koordinimin e transportit, komunikimin, si edhe plotësimin e kërkesave të ndryshme.
- Organizon pritjen dhe përcjelljen e pjesëmarrësve dhe të ftuarve, akomodimin dhe ushqimin e tyre, organizimin e planit ditor të punës etj.
- Organizon kokteilet dhe pritjet e tjera që mund të organizohen në hapje, gjatë apo në mbyllje të Festivalit.

#### **iii. Njësia e Marketingut dhe Financës, e cila ka për detyrë:**

- Sigurimi i fondeve plotësuese të Festivalit, mirëadministrimi i fondeve në dispozicion të realizimit të Festivalit, kryerjen në kohë të pagesave dhe hartimin e raporteve të pjesshme dhe përfundimtare për financuesit, donatorët dhe Drejtorin e Festivalit, sipas shpenzimeve e parashikuara në projekt-buxhetin e Festivalit. Hartimi i kontratave me partnerët, financuesit dhe donatorët.

#### **iv. Njësia e shërbimeve teknike, e cila ka detyrë:**

- Përcaktimin, organizimin dhe sigurimin e mjeteve teknike të projektimit të filmave. Mirëmban dhe kujdeset për mirëfunksionimin e aparaturave.

- Garanton mbarëvajtjen nga ana teknike të aparaturave për konferencat e shtypit, debatet, seminarët, festat, spektaklet e hapjes dhe të mbylljes së Festivalit, etj.

- Në rast se lind nevoja, gjatë realizimit të Festivalit mund të ngrihen edhe njësi, apo grupe pune të tjera.

**v. Njësia e vullnetarëve, e cila ka për detyrë:**

- Përzgjedh të rinjtë e qytetit të Kuçovës që shprehin dëshirën për të qenë vullnetarë në Festival;

- Organizon vullnetarët që do të angazhohen gjatë Festivalit;

- Drejton dhe ndan detyrat konkrete që duhet të bëjë secili vullnetar;

- Ndhmon produksionin me vullnetarë për të garantuar mbarëvajtjen e Festivalit.

**NENI 7**

**VEPRIMTARIA E JURISË SË FESTIVALIT**

7.1. Juria në punën dhe vendimmarrjen e saj është krejtësisht e pavarur.

7.2. Juria mund t'i shohë filmat edhe para Festivalit, por detyrimisht duhet t'i shohi të gjithë filmat gjatë ditëve të Festivalit. Përrjashtohet nga e drejta e pjesëmarrjes në dhënien e çmimeve, ai anëtar jurie që nuk i ka parë të gjithë filmat në konkurim. Në një rast të tillë, anëtari i jurisë humb edhe të drejtën e votës.

7.3. Vendimi për ndarjen e kupave dhe të çmimeve të tjera, juria e merr me pjesëmarrje të plotë, me votim të hapur dhe me shumicën e votave të anëtarësisë.

7.4. Në rast pamundësie për të marrë pjesë fizikisht gjatë ditëve të Festivalit një anëtar jurie, do të zëvendësohet me një anëtar të ri.

## NENI 8

### KRITERET E PRANUESHMËRISË

8.1. Të drejtë pjesëmarrjeje në KIIFFF kanë filmat e pavarur nga e gjithë bota, pa asnjë kushtëzim për shtetësinë e filmit, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë apo bindjeve politike të autorëve.

8.2. Filmat duhet të jenë prodhuar pas datës 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2024.

8.3. Gjatësia e filmave:

- Film artistik me metrazh të gjatë jo më pak se 70 minuta, përfshirë titrat hyrëse dhe fundore;
- Film artistik me metrazh të shkurtër deri në 30 minuta, përfshirë titrat hyrëse dhe fundore;
- Film dokumentar jo më pak se 30 dhe jo më shumë se 65 minuta, përfshirë titrat hyrëse dhe fundore;
- Film i animuar jo më shumë se 30 minuta, përfshirë titrat hyrëse dhe fundore.

8.4. Pranohen në konkurim filmat e zhanreve të mëposhtme: fiction/live action, dokumentarë, animacion, eksperimentalë.

8.5. Filmat që janë në fazë të papërfunduar (work in progress) pranohen vetëm nëse pranohet në mënyrë eksplicite nga Autori, i cili garanton se versioni final do të dërgohet brenda afatit të dorëzimit të linqeve të përcaktuar nga Festivali.

## NENI 9

### INDEPENDENT FILM FESTIVAL GJUHA DHE TITRAT

9.1. Gjuha zyrtare e Festivalit KIIFFF është shqip dhe anglisht.

9.2. Të gjithë filmat jo-anglishtfolës duhet të kenë titra në anglisht në versionin e dërguar për seleksionim dhe në kopjen përfundimtare për shfaqje.

## **NENI 10**

### **APLIKIMI DHE MATERIALET E NEVOJSHME**

10.1. Aplikimi bëhet përmes platformës FilmFreeway, si dhe në faqen zyrtare të KIIFFF. Çdo film duhet të ketë aplikim të veçantë.

10.2. Aplikimi duhet të përmbajë (Aneksi nr. 1 bashkëlidhur Rregullores):

- Link screener online (Vimeo, FilmFreeway ose platformë tjetër e mbështetur), me cilësi të mjaftueshme shikimi;
- Synopsis i shkurtër i filmit;
- Bio e regjisorëve dhe filmografia e tyre;
- Poster i filmit në rezolucion të lartë;
- 3–5 stills nga filmi (jo fotografi prapaskene);
- Të dhëna teknike bazë (gjerësia, formati, rezolucioni, raporti i figurës, etj.).

10.3. Aplikimet e paplota nuk do të merren në konsideratë nga Komisioni i Seleksionimit.

## **NENI 11**

### **TARIFAT E APLIKIMIT DHE AFATET**

11.1. Aplikimi në Edicionin 1 të KIFFF është pa pagesë, përveç tarifave dhe komisioneve të platformës FilmFreeway. Ato janë të parimbursueshme, pavarësisht rezultatit të seleksionimit.

11.2. Afatet e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe në kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të KIFFF.

## **NENI 12**

### **PROCESI I SELEKSIONIMIT**

12.1. Të gjitha aplikimet shqyrtohen nga Komisioni i Seleksionimit i përcaktuar nga KIIFFF.

12.2. Vendimet e Komisionit të Seleksionimit janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë. Festivali nuk është i detyruar të ofrojë argumentime individuale për filmat që nuk për zgjidhen në konkurim.

12.3. Autori/producenti pranon që, nëse filmi për zgjidhet, ai mund të programohet nga Festivali në çdo seancë gjatë datave të KIIFF, sipas planifikimit të drejtuesve të programit.

### **NENI 13**

#### **JURIA DHE ÇMIMET**

13.1. Fituesit shpallen nga Juria e përbërë nga profesionistë të fushës së filmit, artit dhe industrive kreative. Përbërja e Jurisë publikohet përpara fillimit të Festivalit në faqen zyrtare të internetit dhe në kanalet e rrjeteve sociale të KIFF.

13.2. Juria është e pavarur në vendimmarrjen e saj; vendimet e Jurisë janë përfundimtare.

13.3. Festivali do të akordojë çmime të ndryshme (trofe, certifikata dhe çmime monetare), të cilat publikohen në njoftimin zyrtar për thirrjen e filmave.

13.4. Festivali rezervon të drejtën të mos akordojë një çmim nëse niveli artistik i filmave në një kategori konsiderohet jo i mjaftueshëm.

### **NENI 14**

#### **FORMATI I SHFAQJES DHE DËRGIMI I KOPJEVE**

14.1. Pasi një film për zgjidhet, autori/producenti duhet të dërgojë brenda afatit të caktuar nga Festivali kopjen finale të filmit në formatin teknik të kërkuar (Aneksi 2 bashkëlidhur Rregullores).

14.2. Të gjitha kostot e përgatitjes së materialeve teknike (titra, dërgesa online, etj.) janë përgjegjësi e aplikantit.

14.3. Festivali nuk paguan tarifë qiraje (rental fee) për shfaqjet e filmave në programin zyrtar.

## **NENI 15**

### **TË DREJTAT E AUTORIT DHE PËRGJEGJËSITË LIGJORE**

15.1. Duke aplikuar në KIIFFF, aplikanti deklaron se është mbajtësi ligjor i të drejtave të filmit ose person i autorizuar nga mbajtësi ligjor, dhe se filmi nuk shkel të drejtat e autorit, të drejtën e imazhit, markat tregëtare apo çdo të drejtë tjetër të palëve të treta.

15.2. Aplikanti merr përsipër përgjegjësinë e plotë ligjore për përmbajtjen e filmit dhe materialeve të dorëzuara. Festivali nuk mban përgjegjësi për çështje të mundshme ligjore që rrjedhin nga shkelja e këtyre të drejtave.

15.3. Në rast të ndonjë pretendimi ligjor, Festivali rezervon të drejtën të skualifikojë filmin nga programi dhe të heqë çdo material të tij nga kanalet e komunikimit.

## **NENI 16**

### **PËRDORIMI I MATERIALEVE PROMOCIONALE**

16.1. Duke aplikuar në KIIFFF, aplikanti i jep Festivalit të drejtën jo-ekskluzive të përdorë fragmente të shkurtra të filmit (maksimumi 2 minuta), posterin, stills dhe materiale të tjera promociionale për qëllime promovimi të Festivalit në media, rrjete sociale, katalog, trailer festivali, etj.

16.2. Këto përdorime nuk përfshijnë asnjë kompensim financiar për aplikantin dhe nuk çenojnë të drejtat e tij për shfaqje të tjera jashtë KIIFFF.

## **NENI 17**

### **UDHËTIMI DHE AKOMODIMI**

17.1. KIIFFF, në bazë të burimeve buxhetore, do të ofrojë mbështetje të pjesshme ose të plotë për akomodimin e regjisorëve/producentëve të filmave të përzgjedhur. Këto kushte komunikohen rast-pas-rasti nga organizatori.

17.2. Udhëtimi drejt dhe nga Kuçova është përgjegjësi e pjesëmarrësve, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshje specifike.

## **NENI 18**

### **ANULIME TË MUNDSHME**

18.1. Festivali rezervon të drejtën të anulojë edicionin ose të bëjë ndryshime të konsiderueshme në strukturë, datë ose format (p.sh. kalimi në format online ose hibrid) në raste force madhore, ose rrethana jashtë kontrollit të organizatorëve.

18.2. Në rast anulimi total të edicionit, organizatori do të informojë aplikantët dhe mund të ofrojë zgjidhje alternative (p.sh. transferim të aplikimeve në edicionin pasardhës).

## **NENI 19**

### **PRANIMI I RREGULLORES**

19.1. Dërgimi i aplikimit në KIIFP përmes FilmFreeway nënkupton pranimin e plotë dhe pa rezervë të kësaj Rregulloreje nga aplikanti.

19.2. Në rast mospërputhje midis versionit në gjuhë të ndryshme, versioni në gjuhën anglisht konsiderohet përfundimtar.

19.3. Në çdo rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e kësaj Rregulloreje, vendimin përfundimtar e marrin drejtuesit e Festivalit.

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën 20.05.2026

**PRESIDENTI I KIIFP**

**DREJTORI I KIIFP**

**Kryetari i Bashkisë Kuçovë**

**Kreshnik HAJDARI**

**Steljo GAÇE**

## ANEKSI 1

### Formulari i Dorëzimit të Filmit

### Kuçova International Independent Film Festival (KIIFF)

#### Informacion mbi filmin

- Titulli i filmit: \_\_\_\_\_
- Regjisori: \_\_\_\_\_
- Vendi i origjinës: \_\_\_\_\_
- Viti i prodhimit: \_\_\_\_\_
- Kohëzgjatja (minuta): \_\_\_\_\_
- Gjuha: \_\_\_\_\_
- Titra (nëse ka): \_\_\_\_\_

#### Specifikimet teknike

- Rezolucioni:  1920x1080 (Full HD)  3840x2160 (Ultra HD / 4K)
- Formatimi i file-it:  MP4 (H.264)  MKV (H.265/HEVC)
- Frame rate:  24 fps  25 fps  Tjetër: \_\_\_\_\_
- Audio:  Dolby Digital 5.1  Stereo WAV/PCM
- Sample rate:  48 kHz

#### Dorëzimi i file-it

- Media:  HDD/SSD  USB 3.0
- Emri i file-it: \_\_\_\_\_
- Kopje rezervë e dorëzuar:  Po  Jo

#### Informacion kontakti

- Emri i dorëzuesit: \_\_\_\_\_
- Email: \_\_\_\_\_
- Telefoni: \_\_\_\_\_
- Adresa: \_\_\_\_\_

**Deklaratë** Me këtë konfirmoj se filmi i dorëzuar është në përputhje me udhëzuesin teknik të festivalit dhe se jam i autorizuar ta dorëzoj këtë vepër.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

## ANKESI 2

### Formati i pranueshëm i dorëzimit të Filmit

#### Kuçova International Independent Film Festival (KIIFFF)

- Titrat duhet të dorëzohen vetëm në format **SRT**.
- File-t e titrave duhet të jenë të veçantë nga videoja. Titrat të ngjitur mbi film (hardcoded) **nuk pranohen**.

#### Gjuha e titrave

- Titrat në **anglisht** janë të detyrueshme për të gjithë filmat.
- Festivali rezervon të drejtën t'i zëvendësojë titrat në anglisht me titra në **shqip** për shfaqjet publike.

#### Sinkronizimi (Time Code)

- Titrat duhet të jenë të **sinkronizuara saktësisht me minutazhin e filmit (timecode)**.
- File-t që nuk janë të sinkronizuara nuk do të pranohen.
- Krijuesit janë të detyruar të testojnë paraprakisht titrat e tyre në një media player (p.sh. VLC) për të verifikuar sinkronizimin.

#### Dorëzimi i file-it të titrave

- File i titrave duhet të ketë të njëjtin emër si file i videos (p.sh. *Titulli.mp4* dhe *Titulli.srt*).
- Titrat duhet të dorëzohen bashkë me filmin, në një folder të veçantë.

#### Testim paraprak

- Organizatorët do të kryejnë një testim paraprak të titrave për të siguruar që janë të lexueshëm dhe të sinkronizuar.
- Në rast problemesh teknike, krijuesi do të njoftohet për të dorëzuar një version të korrigjuar.